



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- * **Aktivitetet e përgjithshme**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- * **Aktivitetet nga trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive**
- * **Aktivitetet trajnuese për gjyqtarët porotë**
- * **Aktivitetet për trajnues**

Qershor 2023

Aktivitetet e përgjithshme

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas

Me 12 qershor 2023 në Akademi të Drejtësisë është realizuar takimi i përbashkët mes përfaqësuesve të dy institucioneve z. Enver Fejzullahu-Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë dhe znj. Flutra Berbati-Zena-zv. Drejtoreshë e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas si dhe z. Qëndrim Gashi -zyrtar në këtë Agjenci.

Qëllimi i këtij takimi ishte fuqizimi edhe më tej i bashkëpunimit ndërinstitucional në çështjet me interes të përbashkët dhe konkretizimi i saj përmes nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit mes institucioneve përkatëse.

Gjatë takimit u diskutua për bashkërendimin e aktiviteteve në përmbushje të veprimtarisë sipas

Ligjit për Ndhimën Juridike Falas dhe Ligjit për Akademinë e Drejtësisë si dhe gjithashtu kërkesave të Strategjisë për sundimin e Ligjit në ngritjen e kapaciteteve profesionale për përmirësimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas.

Në fund të takimit z. Fejzullahu dhe znj. Zena nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet të dy institucioneve si formë bazë përmes të cilës zyrtarët e Ndhimës Juridike Falas do të përfitojnë nga Programet trajnuese të AD-së dhe veçanërisht në trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë në çështjet ligjore që janë kompetencë e punës së tyre.



Drejtori Ekzekutiv priti në takim ekspertët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës – Zyra e arsimit ligjor (OLE)

Më 12 qershor 2023, Drejtori Ekzekutiv i AD-së z. Enver Fejzullahu priti në takim tre (3) ekspertët e Zyrës së arsimit ligjor (OLE) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, znj. Kimberly Klein, znj. Beard Lynn dhe znj. Stani Day.

Qëllimi i vizitës së ekspertëve nga zyra OLE është zhvillimi i Trajnimit të Trajnuesve për certifikimin e trajnuesve brenda AD-së.

Gjatë takimit Drejtori Ekzekutiv i AD-së shprehi falënderim dhe mirënjohje për tërë mbështetjen që AD ka nga Ambasada Amerikane dhe programi i OPDAT në

zhvillimin e Trajnimeve për Trajnues dhe aktivitetet tjera, dhe njëherit shprehi gatishmërinë e tij për vazhdimin e bashkëpunimit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Përveç hapësirave të AD-së, ekspertët patën rastin të njoftohen edhe me disa prej trajnuesve të AD-së, të cilët do shërbejnë si facilitator gjatë Trajnimit 3 ditor i cili do zhvillohet nga dt. 13-15 qershor 2023, në bashkëpunim me programin e OPDAT.



Takimi me gjyqtarët dhe kuadrin tjetër ligjor të Gjykatës Komerciale për prezantimin e Draft Raportit të vlerësimit të nevojave trajnuese për Gjykatën Komerciale

Me 23 qershor 2023, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të Programit të USAID-it për Drejtësi Komerciale ka realizuar një takim të përbashkët me gjyqtarët dhe kuadrin tjetër ligjor të Gjykatës Komerciale për vlerësimin e nevojave trajnuese dhe për përcaktimin e kurrikules trajnuese për drejtësinë komerciale.

Në takim ishin të pranishëm përveç përfaqësuesve të AD-së edhe kryetari i Komisionit për trajnime nga KGJK, z. Vilard Bytyqi, z. John Moran nga Departamenti i Shtetit të SHBA-ve, z. Dragomir Jordanov nga EKOJUST, Drejtori i Programit të USAID-it -

Drejtësia Komerciale, z. Chris Thompson si dhe Ekspertja e Lartë për ngritjen e kapaciteteve nga ky program, znj. Zllatlava Mihajlova.

Me rastin e këtij takimi është prezantuar raporti me gjetjet nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për drejtësinë komerciale si dhe rekomandimet për trajnime dhe përmbytjen e saj.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë të Gjykatës Komerciale.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e IX)- 2022-2023



Për 5 prokurorët e kësaj gjenerate jgjatë muajit qershor janë realizuar gjithsej 7 sesione të trajnimit teorik dhe 18 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, moduli: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale.

Nga moduli Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë realizuar 4sesione trajnuese. Dy sesione për veprat penale nga kapitulli 401 i këtij kodi dhe korrupsioni si dhe dy sesione për

përgjegjësinë e personave juridik dhe për bazat dhe kufirin e përgjegjësisë së personave juridik.

Nga moduli: “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar” janë realizuar 2 sesione trajnuese për “për të drejtën e BE-së me theks te vendimmarjja e BE-së si dhe qytetaria e BE-së dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Në kuadër të modulit: “Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale” është realizuar 1 sesione trajnuese për arsyetimin e vendimeve dhe akteve akuzuese.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.



Trajnimi praktik për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e IX)- 2022-2023

Gjatë muajit qershor 45 gjyqtarët e gjeneratës së IX kanë vijuar sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar.

Gjatë kësaj periudhë janë realizuar gjithsej 22 ditë trajnimi praktik, pjesë kjo e trajnimit e cila është realizuar nën mbikëqyrjen e gjyqtarit/mentor.

Në kuadër të këtij trajnimi, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë shqyrtuar lëndët dhe kanë asistuar në të gjitha aktivitetet gjyqësore që kanë qenë sipas planit të punës

gjatë muajit qershor duke ndërmarrë veprimet e duhura për lëndët përkatëse me rastin e praktikës.

Mentorët kanë qenë të koordinuar me Akademinë e Drejtësisë në përmbushje të trajnimit praktik sipas kompetencave të përcaktuara me Programin Trajnues.

Gjithashtu vijueshmëria e tyre në trajnimin praktik gjatë muajit ka qenë e rregullt dhe me këtë është përmbush trajnimi praktik sipas kalendarit trajnues.

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e X)-2023 -2024



Gjatë muajit qershor për 29 gjyqtarët e sapo emëruar (një prej tyre nga komuniteti boshnjak) janë realizuar gjithsej 42 sesione të trajnimit teorik nga nën modulet e modulit: E drejta civile, ekonomike dhe administrative si dhe të modulit: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese.

Nga nën moduli: “Procedura kontestimore-pjesa e dytë” janë realizuar 5 sesione trajnuese me theks te ndërprerja dhe posedimi i procedurës, procedura e posaqme kontestimore, simulimi i seancës përgatitore dhe simulimi i seancës kryesore.

Nga nën moduli: “Procedura përmbarimore”

janë realizuar 2 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar te Mjetet, objekti dhe zbatimi i përmbarimit;

Nga nën moduli: “E drejta administrative” janë realizuar 10 sesione trajnuese. të cilat kanë përfshirë procedurën administrative, fillimin e procedurës, procedimi administrativ deri në nxjerrjen e aktit administrativ, akti administrativ, mjetet juridike, konflikti administrativ, ekzekutimi i vendimit përfundimtar administrativ (kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit), padia në konflikt administrativ dhe procedura paraprake në konfliktin administrativ dhe seanca e shqyrtimit kryesor.

Në kuadër të nën modulit “E drejta e detyrimeve” janë realizuar 10 sesione trajnuese, me ç’rast janë trajtuar nocioni karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve, kontratat e detyrimeve, shuarja e kontratave, parashkrimi, shpërblymi i dëmit, mjetet reale dhe personale ekzekutimi i mjeteve, kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, kontrata për shitjen, dhe kontrata mbi qiranë.

Nga nën moduli e “E drejta ekonomike” janë realizuar gjithsej 7 sesione trajnuese me ç’rast janë shtjelluar: kontratat në ekonomik, punët bankare dhe siguroese, kontratat e kredisë, sigurimi i dëmit, kontratat e ndërtimit kompensimi i dëmit, efektet e shkëputjes së kontratës dhe markat tregtare.

Në kuadër të nën modulit: “E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera sendore” janë realizuar 6 sesione trajnuese, me ç’rast janë trajtuar e drejta e pronësisë, bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët, mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë, fitimi derivativ dhe origjiner i të drejtës së pronësisë, mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë, të drejtat sendore në sendet

e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, dhe mbrojtja e servituteve sendore dhe posedimi dhe mbrojtja e posedimit.

Në vijim të modulit: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese është realizuar sesi I radhës për ndërmjetësimin në lëminë civile.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik gjyqtarët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore për të gjitha çështjet ligjore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.



Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024

Gjatë muajit qershor për 21 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar gjithsej 16 sesione të trajnimit teorik dhe 13 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe nga Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të modulit: Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë realizuar 12 sesione trajnuese nga nën moduli: “Kodi Penal-pjesa e përgjithshme” nga i cili janë trajtuar: dhuna dhe kanosja, dashja, bashkëpunimi në kryer e veprës penale, shtytja, mbrojtja e nevojshme, pakujdesia, marrëveshja për të kryer veprën penale, sanksionet dënimet kryesore, dënimet plotësuese, lajthimi dhe pasojat juridike, rehabilitimi i të dënuarve dhe parashkrimi. Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe 3 sesione nga nën moduli “Kodi Penal-pjesa e

veçantë” me ç’rast janë trajtuar vepra penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës dhe veprat penale kundër integritetit seksual dhe veprat penale kundër të drejtave të njeriut.

Në kuadër të modulit: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar është realizuar 1 sesion trajnues për të drejtën e BE-së me theks te roli dhe rëndësia e Këshillit të Evropës.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Arbitrazhi

Më 01 Qershor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Arbitrazhi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Përmbarrimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunalet e Arbitrazhit brenda dhe jashtë Kosovës.

Trajnimi është fokusuar në rolin e formave alternative të zgjidhjes së kontesteve me theks te Arbitrazhit, në radhë të parë për sigurinë juridike dhe mundësinë e tërheqjes së investimeve të huaja aq të nevojshme për zhvillimin e ekonomik e më pas u diskutua për procesin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit, përmbarrimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunalet e Arbitrazhit brenda dhe jashtë Kosovës.

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin e studimit dhe analizimit të një rasti praktik përmes të cilit u sqaruan aspekte të rëndësishme që gjyqtarët hasin gjatë procedurës së njohjes dhe përmbarrimit të vendimeve të arbitrazhit, Zbatimin e drejtë të bazës ligjore të arbitrazhit; Unifikimin e praktikës së njohjes së arbitrazhit dhe Rast praktik.

Metodologjia e zbatuar ishin e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 26 gjyqtarë. Prej tyre 2 gjyqtarë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 3 nga Gjykata e Apelit, 8 nga Gjykata Komerciale dhe 2 nga Gjykatat Themelore dhe 4 Avokatë Shtetërorë.



Program i Specializuar i Trajnimit-Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare-Sesioni II

Më 06-07 qershor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit-Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zbatuesve tjerë të ligjit lidhur me elementet e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore dhe zgjidhjen meritorë të rasteve përkatëse.

Në ditën e parë trajnimi u përqendrua në pasqyrën e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare me fokus te dashja si element i veprës penale, çështjet e realizimit apo mos realizimit të dëmit apo përfitimit, vlerësimit të provave bindëse, krijimit të figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethore, mashtrimit në prokurim si vepër e ndërlikuar, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar.

Në ditën e dytë trajnimi u përqendrua te keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar kur bëhet fjalë për keqpërdorimet në detyrë,

përkatësisht lidhur me detyrën; kryesi i kësaj vepre penale, përmes veprimeve juridike në fushëveprimin e tij zyrtar, përdor autorizimet e tij në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht kryesi i kësaj vepre penale shfrytëzon në mënyrë të kundërligjshme mundësitë reale dhe juridike të lidhura me pozitën zyrtare, duke kryer veprime të cilat, për nga karakteri i tyre, nuk janë zyrtare, po veprime të rëndomta deliktore.

Gjatë trajnimit u konfirmua se keqpërdorimin i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale (ajo mund të tërheqë përgjegjësi disiplinore, administrative, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjërin nga alternativat që kërkohen me ligj - përfitimin, dëmin-shkeljen).

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 24 pjesëmarrës. Prej tyre 14 gjyqtarë 9 prokuror dhe 1 bashkëpunëtorë profesional.



Trajnim: Ndryshimet e KPP-së në fushën e Trafikimit me Qenie Njerëzore

Më 07 Qershor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në mbështetje dhe bashkëpunim me projektin Forcimi i veprimeve anti-trafikim të Këshillit të Evropës është realizuar trajnimi me temë “Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në fushën e Trafikimit me Qenie Njerëzore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të prokurorëve lidhur me ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale në fushën e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe zbatimi i drejtë i tyre në praktikë në rastet përkatëse.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtua Trafikimi me qenie njerëzore dhe ndërlidhja me veprat tjera penale duke përfshirë edhe kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare në fushën e

parandalimit dhe luftimit të qenieve njerëzore si dhe mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimeve për viktimat e trafikimit.

Në pjesën e dytë vëmendje iu kushtua Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht dispozitave në fushën e trafikimit me qenie njerëzore me theks te mbrojtja dhe përfaqësimi ligjor, të drejtat e viktimës dhe kompensimi si dhe ndryshimet në zbatimin e masave të fshehta dhe veprimet institucionale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 8 prokuror, 4 mbrojtës të viktimave si dhe 15 zyrtarë policor .



Punëtori për unifikimin e praktikës gjyqësore-pjesa penale për Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit

Më 07 Qershor 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar punëtorinë “Unifikimi i praktikës gjyqësore për çështje penale”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte unifikimi i praktikës gjyqësore në çështjet penale. Fokusi i kësaj punëtorie ishte në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve aktuale sa i përket praktikës gjyqësore.

Punëtorja si fillim u fokusua në identifikimin e praktikës jo unike gjyqësore në çështje penale për të cilën u zhvillua një debat konstruktiv dhe i hapur mes gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit. Çështjet për të cilat u konfirmua se kanë nevojë për unifikim të praktikës gjyqësore ishin respektimi i dispozitave që kanë të bëjnë me të drejtat e palëve në procedurë, pastaj dhënia e udhëzimeve të duhura me rastin e anulimit të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë përfshirë edhe respektimin e të drejtave të njeriut gjatë mbajtjes së seancave të kolegjit. Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe rasteve të

gjykimit në mungesë sipas dispozitave ligjore të Kodit të ri të Procedurës Penale.

Gjyqtarët pjesëmarrës në punëtori treguan përkushtim përmes punës në grupe dhe debatore profesionale për secilën çështje ligjore të identifikuar duke dhënë propozime dhe arrit pajtueshmëri për propozimet e parashtruara në mënyrë të unifikuar. Këto konkluzione pas finalizimit nga ana e Gjykatës së Apelit do të publikohen në web të Akademisë së Drejtësisë, dhe do të jenë të qasshme për gjithë gjyqtarët që punojnë në rastet përkatëse.

Kjo punëtori nga ana e gjyqtarëve pjesëmarrës rezultojë suksesshme dhe se konkluzionet e nxjerra do lehtësojnë punë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit.

Në punëtori ishin 11 gjyqtarë dhe 2 bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata e Apelit të cilët ishin nga radhët e Departamentit Special, Krimeve të rënda, Departamentit të përgjithshëm dhe Departamentit për të Mitur..



Trajnim: Procedura penale ku përfshihen kryesit e ç'rregullimeve mendore

Më 8 qershor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të procedurës penale sipas ligjit të ri në rastet kur kryes i veprës penale është me çrregullime mendore përfshirë këtu edhe në kuptimin e kushteve lidhur me aftësinë e këtyre personave për t’iu nënshtruar gjykimit.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua: korniza ligjore vendore e cila rregullon këtë sferë, kushtet për shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm. Në veçanti u diskutua trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjithashtu, u shtjellua edhe zbatimi i ekzaminimit psikiatrik nga eksperti, qëllimi i këtij ekzaminimi dhe fazat e dhënies së urdhrit për ekzaminim psikiatrik me ç’ rast u potencua niveli jo i kënaqshëm i ekspertizave të përgatitura nga ekspertët. Vëmendje iu kushtua edhe paraburgimit dhe kushtet e veçanta që duhet plotësuar për të përcaktuar paraburgimin ndaj personave me çrregullime mendore.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit të rasteve konkrete nga praktika gjyqësore për të cilat u ofruan perspektivat e tyre për vendosjen meritore të rasteve përkatëse

Këtë trajnim e vijuan 34 pjesëmarrës. Prej tyre 27 gjyqarë dhe 7 prokurorë kryesisht të nivelit themelor nga të gjitha Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.



Trajnim: Trajnim për praktikën gjyqësore për mbrojtjen gjyqësore në kontestet e punës, sipas Ligjit të Punës



Me 08 qershor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar “Trajnimin mbi praktikën gjyqësore për mbrojtjen gjyqësore në kontestet e punës, sipas Ligjit të Punës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe adresimi i sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës së punës.

Në pjesën e parë u trajtuan temat për: Kontratat e punës dhe llojet e tyre; Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës; dhe Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore më saktësisht çështja e shterimit të mjeteve të brendshme juridike për të fituar të drejtën e kërimit të mbrojtjes gjyqësore si dhe pasojat juridike të mos respektimit të afateve ligjore tek kontestet e punës dhe Zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive dhe Sektoriale.

Që në fillim u shtjelluan çështjet rreth procedurës së filluar nga punëmarrësit në rastet e shkeljeve të detyrave të punës nga ana e punëdhënësve, përfshirë këtu edhe identifikimin e kushteve paraprake të cilat duhet të plotësohen nga kërkuesi para se t'i drejtohet gjykatës me padi për të siguruar mbrojtje gjyqësore në konteste të tilla. Në trajnim u prezantuan sfidat aktuale të identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat u zbërthyen

përmes rasteve konkrete.

Në trajnimin gjithashtu u shtjellua natyra juridike e kontesteve të punës, procedurën gjyqësore që zhvillohet tek kontestet e punës, llojet e vendimeve gjyqësore, procedurat brendshme të cilat duhet të shfrytëzohen punëtorët para se të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, përfshirë këtu edhe kompetencën, afatet dhe mjetet juridike.

Gjithashtu në trajnim u potencua se gjatë procedimit të kontesteve të punës shpeshherë ka pasur paqartësi lidhur me atë se çka vlerëson gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes në këto konteste, a e vlerëson gjykata vetëm ligjshmërinë e vendimit kundër të cilit është ngritur padia, apo edhe mund të lëshohet edhe në vlerësimin e asaj se a është vërtetuar gjendja faktike nga ana e punëdhënësit me rastin e shpëputjes së marrëdhënies së punës punëtorit. Pas diskutimeve u konkludua se gjykata në procedurën kontestimore sipas padisë së ushtruar nga punëtori e vlerëson ligjshmërinë e vendimit, kundër të cilit është ngritur padia dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara, si dhe nga lloji i kërkesës së paditësit merr vendimin përkatës në formë të aktgjykimit.

Në këtë trajnim u identifikuan sfidat në zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës, të cilat ndërlidhen me mbrojtjen gjyqësore në kontestet e punës; u identifikuan edhe praktikat jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta duke u adresuar përmes shpjegimit dhe prezantimit të praktikës unike gjyqësore në formë të konkluzioneve nga trajnuesit.

Përfitues në këtë trajnim ishin 30 pjesëmarrës. Prej tyre 1 nga Gjykata Supreme, 4 nga Gjykata e Apelit dhe 20 gjyqtarët e Gjykatave Themelore nga të gjitha regjionet si dhe 5 avokat shtetërorë.

Trajnim: Veprat penale kundër integritetit seksual të femijëve

Më 13 Qershor 2023, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar Trajnimin me temë “Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me trafikimin me njerëz dhe kontrabandimit me migrant, ku të dëmtuar janë fëmijët, që si rezultat i kësaj në praktikë gjatë hetimit dhe gjykimit të këtyre rasteve ka probleme rreth aplikimit të dispozitave materiale lidhur me këto vepra penale.

Trajnimi ishte përqendruar në shpjegimet e nevojshme sa i përket kujdesit që duhet pasur institucionet ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale me fokus te procedura për shkak të moshës, karakteristikave personale, nevojat e veçanta, edukimin dhe ambientin në të cilin ka jetuar, në mënyrë që t’iu shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar kontrollimit të fëmijës me ndihmën e pedagogut, psikologut ose të ndonjë eksperti

tjetër profesional duke vënë në pah edhe marrjen në pyetje të fëmiut ose të miturit nëpërmjet gjyqtarit kompetent, ndërsa, sipas nevojës, me ndihmën e pedagogut, psikologut ose të personit tjetër profesional. Çdo veprim ndryshe konsiderohet jo adekuate dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi e po ashtu edhe me standardet dhe konventat e fëmijëve me theks te Konventa Lanzarote. Kjo konventë si u tha është një hap i madh përpara në parandalimin e krimeve seksuale kundër fëmijëve, ndjekjen e kriminelëve dhe mbrojtjen e viktimave fëmijë. Duke u bazuar në standardet aktuale ndërkombëtare dhe rajonale, Konventa i zgjeron për të mbuluar dhe kriminalizuar të gjitha krimet seksuale kundër fëmijëve, pa dallim a janë për përfitim komercial ose jo.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 21 pjesëmarrës. Prej tyre 17 gjyqtarë dhe 4 prokurorë kryesisht të Nivelit Themelor nga Departamenti për të Mitur dhe Departamenti i përgjithshëm.



Trajnim i specializuar i trajnimit gjyqësor mbi Evidencën Elektronike

Me date 13-16 qershor 2023, nga Projektit iPROCEEDS-2, në Tiranë- Shqipëri u realizua Kursi i specializuar i trajnimit gjyqësor mbi Evidencën Elektronike.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive praktike për të përmbushur rolet dhe funksionet e tyre përkatëse në rastet e krimit kibernetik lidhur me vlerën provuese dhe çështjet e pranueshmërisë për provat elektronike.

Trajnimi ishte i projektuar si një trajnim intensive për pjesëmarrësit. Me ç'rast pjesa e parë e trajnimit u përqendrua në dhënien e njohurive nga trajnerët, ndërsa pjesa tjetër e trajnimit kërkoi që pjesëmarrësit të punojnë në një skenar rasti. Ky skenar në thelb të trajnimit përfshinte dosjen e rastit, materialin video, raportet, urdhëresat dhe deklaratat për mbledhjen dhe ekzaminimin e provave elektronike.

Gjatë këtij trajnimi u elaborua krimi kibernetik, provat elektronike dhe hetimet financiare përkatëse, masat kundër pastrimit të parave me fokus në mbrojtjen e të dhënave dhe mbrojtjen e sundimit të ligjit. Tutje nga pjesëmarrësit u kërkua të vlerësojnë të gjitha provat dhe pranueshmërinë e tyre nga këndvështrime të ndryshme të palëve në sistemin e drejtësisë penale duke përfshirë të gjitha provat në seancë provuese dhe në gjykim. Dita e fundit e trajnimit iu kushtua diskutimeve praktike që përmbledhin zbatimin e njohurive të mësuara në rastet praktike, dhe metodologjinë e ofrimit të trajnimit të veçantë për trajnimin e e-provave.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin: prokurorë, gjyqtarë dhe hetues të krimit kibernetik nga Shqipëria, Kosova, Kepi Verde, Gana dhe Nigeria. Nga Kosova morën pjesë 2 gjyqtarë dhe 5 prokuror.



Trajnim: Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare

Më 15 Qershor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve për industrinë financiare, sektorin bankar dhe atë të sigurimeve duke përfshirë edhe institucionet mikro financiare për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore me rastin e vendosjes në kontestet ku janë të përfshira institucionet financiare.

Trajnimi u fokusua me trajtimin në përgjithësi të industrisë financiare e më pas është vazhduar me qeversijen korporative të institucioneve financiare, sektorin bankar, sektorin e sigurimeve dhe në fund për institucionet mikrofinanciare përfshirë edhe institucionet mikrofinanciare jo bankare.

Me rastin e trajnimit u tha se sistemi financiar është njëri nga sektorët më të rregulluar me legjislacion primar dhe sekondar. Gjithashtu Institucionet financiare shërbejnë si hallka shumë të rëndësishme për zbatimin praktik të politikës monetare të Bankës Qendrore për sigurimin e stabilitetit të çmimeve, rritjes ekonomike dhe të punësimit të plotë.

Vëmendje të veçantë gjatë trajnimit patën rastet hipotetike dhe rastet konkrete nga praktika gjyqësore për të cilat u diskutuan bashkë me pjesëmarrësit e trajnimit dhe njëherësh u ofruan perspektivat e tyre për vendosjen meritorë të rasteve përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 1 gjyqtar dhe 2 bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata Komerciale dhe 1 bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata Themelore në Prishtinë.



Program i Specializuar i Trajnimit-Krimi organizuar-Sesioni

II

Me 19-20 Qershor 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me WBROLI, në kuadër të Programit për Trajnim të Vazhdueshme kanë realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i Organizuar – Sesioni II”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me teknika të veçanta hetimore të krimit të organizuar, mënyrat e vlerësimit të provave në rastet e krimit të organizuar me theks të veçantë të hetimeve financiare.

Trajnimi në ditën e parë u fokusua në definicionet sa i përket krimit të rëndë dhe të organizuar, pastrimit të parave, ryshfetit dhe korrupsionit dhe në vijim një qasje të re që lidhet drejtpërdrejt me ligjet përkatëse në fuqi për të trajtuar meritorisht rastet në gjykata. Vëmendje e veçantë i është kushtuar vlerësimit kombëtar të riskut dhe kriterëve të pranimit të rasteve, parimeve, etikës dhe mbajtjes së të dhënave duke shikuar konceptet më të gjera të hetimit, të cilat tani shtrihen përtej thjeshtë sigurimit të një dënimi – si lidhen tani këta faktorë me praktikën moderne të zbatimit të ligjit, alternativat ndaj ndjekjes penale.

Fokus të veçantë kishte edhe një rishikim i

qasjeve të tjera për të luftuar krimin e organizuar, p.sh., ndërprerje ose mos dënim i bazuar në konfiskim, strategjitë dhe të dhënat, llojet (vëzhgimi, statik, fotografik dhe mobil, dërgesat e kontrolluara, gjurmimi i celularëve, ndërhyrjet në pronë, hetimet e fshehta, vëzhgimi gjurmues (përgjimi i komunikimeve do të ngrihet për diskutim, por nuk do të shqyrtohet në detaje për shkak të kompleksitetit të përfshirë) si dhe kërkesat ligjore, rreziqet dhe konsideratat me theks kufijtë e veprimeve të tilla në lidhje me provat dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Në ditën e dytë, trajnimi ka vazhduar me raste praktike për format e krimit të organizuar në grupe dhe format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale.

Pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të një rasti studimor i cili kishte të bënte me metodat kryesore të Krimit të Organizuar në Britaninë e Madhe.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 14 pjesëmarrës. Prej tyre 4 gjyqtarë dhe 10 prokurorë.



Trajnim për praktikën gjyqësore në çështje administrative



Me 20-21 qershor 2023, në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë dhe me përkrahjen e GIZ-it në kuadër të PTV-së është realizuar tryeza për praktikën gjyqësore administrative në Kosovë dhe në Shqipëri.

Në këtë tryezë panelist-ligjërues ishin: znj. Elvana Çiçolli, Zv.Kryetare e Gjykatës Administrative të Shqipërisë, znj. Delushe Halimi, gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Kosovës - Departamenti Administrativ dhe z. Islam Sllamniku, trajnues gjyqësor i përhershëm në AD-së.

Në ditën e parë të tryezës u trajtuan: Praktika gjyqësore në çështje administrative - Konteksti ligjor kosovar dhe sfidat; Praktika gjyqësore në çështje administrative - Konteksti ligjor i Shqipërisë dhe sfidat si dhe disa Çështje kontestuese me vështirime krahasuese në praktiken gjyqësore të disa shteteve të regjionit dhe praktika e GJEDNJ.

Ndërsa në ditën e dytë janë trajtuar çështjet të cilat në gjyqësinë administrative kosovare po paraqesin dilema të ndryshme profesionale, procedurale dhe materiale përkitazi me vendosjen meritore. Në trajnim u ofruan zgjidhje praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësojnë punën e gjyqtarëve dhe në instancë të fundit do të ndikojnë në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve. Trajnimi u fokusua edhe në procedurën e zhvillimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente

ndaj vendimeve të organeve të administratës publike në Kosovë. Gjithashtu u trajtuan edhe dilemat në praktikën gjyqësore të Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe dilemat në praktikën gjyqësore të Departamentit Administrativ të Gjykatës së Apelit.

Në trajnim u zbërthyen çështjet të cilat kanë shkaktuar vështirësi me rastin e gjykimit në konfliktet administrativ, të njëjtat u adresuan përmes shpjegimeve duke u bazuar në raste praktike dhe shembuj konkret të cilat paraqiten në procedurat gjyqësore gjatë vendosjes së lëndëve konkrete. Përmes diskutimeve dhe shkëmbimit të përvojave gjatë punës së gjyqtarëve u diskutua edhe për rregullat kryesore të kësaj procedure sipas LKA-së, por veçmas për specifikat të cilat i përmban procedura e gjykimit të rastit në merita. Ishte një trajnim me karakter praktik i shoqëruar me diskutime nga pjesëmarrësit si dhe shkëmbim të mendimeve dhe qëndrimeve të kundërta. Përveç gjyqtarëve edhe zyrtarët e institucioneve pjesëmarrëse, gjatë diskutimeve kanë shtruar pyetje dhe dilema.

Në këtë tryezë çështjet e ngritura dhe dilemat u trajtuan përmes shpjegimit të trajnuesve-pane listëve, duke pas në fokus ato që janë paraqitur në praktikë. Trajnimi ishte koncipuar në atë mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit përmes diskutimeve të tyre kontribuan në suksesin e saj.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin 33 pjesëmarrës. Prej tyre një grup i gjyqtarëve nga gjykatat administrative të Shqipërisë dhe nga Kosova duke përfshirë edhe zyrtarë të Ministrisë dhe Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor (Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit) si dhe zyrtarë të ndihmës juridike falas.

Trajnim: Politika ndëshkimore dhe zbatimi i udhëzuesit

Më 21-22 Qershor 2023, bashkëpunim me OPDAT në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Politika ndëshkimore dhe zbatimi i udhëzuesit”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatimin e mirëfilltë të metodave të matjes së dënimit në përputhje me udhëzuesin e politikës ndëshkimore.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në shpjegimet rreth seancës për matjen e dënimit dhe rëndësinë e zhvillimit të kësaj seance. Gjatë diskutimeve u ngritën shqetësime për rastet e shqiptimit të dënimeve pa u bërë vlerësim adekuat i rrethanave dhe po ashtu pa arsytim të mjaftueshëm të këtyre rrethanave. Prandaj, vëmendje gjatë trajnimit iu kushtua, rrethanave lehtësuese dhe rënduese karakteristike e të cilave është se nuk janë shteruese dhe mund të merren edhe rrethana tjera. Gjatë trajtimit të këtyre çështjeve u vu në pah se rrethanat rënduese janë të prira për të qenë më specifike dhe të qarta sesa rrethanat lehtësuese, kurse është në pajtim me konceptin e pranuar se rrethanat të cilat e ashpërsojnë dënimin duhet të jenë të sakta, të qarta dhe të mund të provohen.

Në fokus ishte edhe aktiviteti i Komisionit Kon-

sultativ për Politikë Ndëshkimore duke përfshirë edhe një rast Pratik.

Në ditën e dytë vëmendje e veçantë i është kushtuar metodologjisë së zbatimit të udhëzuesit për matjen e dënimit, metodologjisë së vlerësimit të rrethanave të kategorisë së përgjegjesisë dhe të demit, udhëzuesit për matjen e gjobës, demonstrim praktik i kalkulatorit të gjobës si dhe aspektet specifike të udhëzuesve të dënimeve siç është udhëzuesi i politikës ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit, në mënyrë që të krijohen standarde të barabarta të matjes së dënimit për të gjithë të pandehurit në procedurë.

Gjatë trajnimit u diskutua edhe për mbrojtësit e viktimave të cilët me punën e tyre mund të kontribuojnë në ndriçimin e rrethanave para gjykatës që do të ndikonin për matjen e drejt të dënimit, në përputhje me udhëzuesin e politikës ndëshkimore.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin gjithësejt 12 pjesëmarrës. Prej tyre 10 gjyqtar, 1 prokuror si dhe një bashkëpunëtorë profesional.



Trajnim: Risitë e Kodit të Procedurës Penale

.Me 23-24 Qershor 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT - OSBE, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Risitë e Kodit të Procedurës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njoftohen me Risitë esenciale të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë tendencë për ndryshime të nevojshme dhe efektive.

Trajnimi u orientua në ndryshimet sa i përket hedhjes së kallëzimit penal që reflekton në mundësinë e ankesës ndaj hedhjes së kallëzimeve penale nga Prokurori Shtetit, pasi që më parë nuk lejohej ankesë ndaj hedhjes së kallëzimit qoftë nga ana e parashtruesit apo të dëmtuarit nga vepra penale. Në vijim të risive ligjore u fol edhe për Mbrojtësin e detyruar, mbrojtësin me shpenzime publike dhe kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, të drejtën për të apeluar aktvendimin, masat e veçanta hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, mundësia hetuese e veçantë, hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e

hetimeve). Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Në këtë trajnim u trajtua edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit. Ndër të tjera u shtjellua edhe Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor duke u vazhduar me standardin e rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe procedura penale ku përfshihen kryesisht me çrregullime mendore.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin 25 pjesëmarrës. Prej tyre 6 gjyqtarë, 7 prokurorë, 10 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor, një analist dhe një zyrtarë i SMIL.



Tryezë: Unifikimi i praktikës gjyqësore në çështje civile dhe administrative

Më 26-27 Qershor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar tryeza e dytë me radhë për të përmbushë gjitha çështjet e praktikës gjyqësore të ngritura në tryezën e realizuar muaj më parë, përkatësisht 16 dhe 17 mars 2023 për unifikimin e praktikës gjyqësore për çështje civile dhe administrative”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte vazhdimi i identifikimit të praktikës gjyqësore jo unike në çështjet civile dhe administrative dhe ofrimi i praktikave më të mira.

Në tryezën e parë të realizuar me 16-17 mars 2023 prej 27 propozimeve të cilat u diskutuan u vendos për 12 prej tyre se si të vendoset në të ardhmen ndërkaq 15 tjera të cilat nuk arritën të trajtohen gjatë asaj tryeze ishin objekt i diskutimit në tryezën aktuale.

Fokusi i tryezës ishte në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve aktuale sa i përket praktikës gjyqësore si faktorë me rëndësi për respektimin e parimit të sigurisë juridike, standardet e mbrojtjes së lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit dhe gjetjen e rekomandimeve të nevojshme nga Gjykata e Apelit në rastet e kthimit të lëndëve në

rigjykim në shkallën e parë

Gjatë këtyre dy ditëve gjyqtaret pjesëmarrës i kanë dhënë propozimet e mbetura nga punëtorja e parë dhe si përfundim kanë arritur pajtueshmëri/konkluzione për propozimet e parashtruara në mënyrë të unifikuar. Këto konkluzione pas finalizimit nga ana e Gjykatës së Apelit do të publikohen në web të Akademisë së Drejtësisë dhe do të jenë të qasshme për gjithë gjyqtarët.

Kjo tryezë nga ana e gjyqtareve pjesëmarrës rezultojë si shumë e suksesshme meqë konkluzionet e nxjerra do lehtësojnë punën e gjyqtarëve që merren me rastet përkatëse.

Metodologjia e tryezës ishte diskutim interaktiv, prezantim i çështjeve përmes rasteve, diskutim për rastet dhe përmbledhje e konkluzave për çështjen e diskutuar.

Këtë tryezë e vijuan 18 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit dhe 1 bashkëpunëtorë profesional i kësaj gjykate.



Trajnim: E drejta për liri dhe siguri-zbatimi i nenit 5 të KEDNJ-së dhe roli i Gjykatës Supreme

Më 27 qershor 2023, me përkrahjen e OSBE-së në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “E drejta për liri dhe siguri - zbatimi i nenit 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) dhe roli i Gjykatës Supreme të Kosovës”.

Qëllim kryesor i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive mbi zbatimin e standardeve të GJEDNJ në praktikën e gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës dhe harmonizimi i praktikës gjyqësore në këtë tematikë.

Në këtë trajnim në pjesën e parë u trajtuan: Dispozitat dhe nocionet themelore të nenit 5 të KEDNJ dhe Standardet kryesore të këtij neni lidhur me rastin e ndalimit të personit nga ana e shtetit. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan baza ligjore specifike dhe dispozitat që rregullojnë situatën e të ndaluarit dhe Praktika gjyqësore dhe risitë që sjell ajo lidhur me zbatimin e nenit 5 të KEDNJ. Në fokus ishin edhe interpretimet e GJEDNJ lidhur me aspektet e së drejtës për liri dhe siguri si e drejtë themelore e njeriut.

Në vazhdim u potencua se esenca e nenit 5 të KEDNJ-së është të mbrojë individin nga ndalimi arbitrar edhe pse ndalimi të jetë në harmoni sipas ligjit nacional, do të jetë shkelje e nenit 5 nëse është arbitrar. Gjithashtu u konkludua se sipas nenit 5 par. 1 pika a. të KEDNJ-së, baza ligjore e privimit të lirisë presupozon ekzistimin e vendimit të gjykatës kompetente, meqenëse vendimi për dhënien e dënimit penal sipas ligjeve (kodeve) të natyrës procedurale të shteteve merret në formë të aktgjykimit, rezulton se për privim nga liria duhet të ekzistoj aktgjykimi nga i cili rezulton se personi është dënuar me dënim heqje lirie gjegjësisht burgim.

Në këtë trajnim u paraqiten shpjegime për rëndësinë dhe garantimin e kësaj të drejte me KEDNJ dhe legjislacionin në fuqi në Repub-

likën e Kosovës. Ishte konkludim i përgjithshëm se e drejta në liri dhe siguri e mbrojtur me nenin 5 të KEDNJ, është njëra ndër të drejtat themelore e garantuar me KEDNJ dhe se shkelja e saj konsiderohet si shkelje e rëndë e Konventës.

Gjithashtu u potencua se GJEDNJ në një prej qëndrimeve të saja tregon qartë se neni 5 par. Pika 1 (c) nuk u jep autoriteteve mundësinë për të inkurajuar "një politikë të përgjithshme parandaluese të drejtuar ndaj një personi ose kategorie personash që autoritetet konsiderojnë, me të drejtë ose gabim, si të rrezikshëm për shkak të prirjes së tyre për të kryer veprime të paligjshme". Duhet të ketë një krim "specifik", për të cilin aplikohet privimi i lirisë.

Në Republikën e Kosovës mbrojtja e kësaj të drejte bie në organet e ndjekjes penale: policisë, prokurorisë së shtetit, gjykatave të rregullta, si atyre që zhvillojnë procedurën penale në shkallë të parë, ashtu edhe atyre që vendosin për ankesat kundër aktgjykimeve të shkallës së parë ose mjeteve të jashtëzakonshme juridike të lejuara në kontekstin e çështjeve juridikop penale.

Në vazhdim u potencua se në rast heqjeje lirie, është me rëndësi veçanërisht të madhe që të përmbushet parimi i përgjithshëm i sigurisë juridike. Për pasojë, është thelbësore që kushtet e heqjes së lirisë në bazë të së drejtës së brendshme të jenë të përcaktuar qartësisht, ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që të plotësohet kriteri i “ligjshmërisë” i caktuar nga Konventa, i cili kërkon që çdo ligj të jetë i përcaktuar mjaftueshëm sa t’i japë mundësi çdo individit që - duke pasur në rast nevojë këshillat e dhura - t’i parashikojë, në një shkallë të arsyeshme në rrethanat e çështjes, pasojat që mund të rrjedhin nga një veprim i caktuar.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore e GJEDNJ duke u shoqëruar me diskutime interaktive. Gjithashtu pjesëmarrësit punuan individualisht dhe të ndarë në grupe në analizën e disa rasteve praktike duke zbërthyer dispozitat e nenit 5. të

KEDNJ dhe kërkesave që përmbajnë këto dispozita.

Përfitues në këtë trajnim ishin 8 pjesëmarrës. Prej tyre 6 gjyqtarë dhe 2 prokurorë.

Trajnim: Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në procedurën e kundërvajtjes

Më 30 Qershor 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në procedurën kundërvajtëse”.

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me hartimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore në procedurën kundërvajtëse.

Diskutimi në këtë trajnim është fokusuar në hartimin e drejt të dispozitivit dhe arsyetimin ligjor të tij, identifikimin e llojeve e aktgjyqimeve, dhe mënyrën e arsyetimit të tyre, hartimin e vendimeve gjyqësore sipas standardeve më të larta.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar rasteve nga praktika gjyqësore, parimeve të shkrimit të mirë ligjor dhe poashtu kërkesave ligjore për përmbajtjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 9 gjyqtarë. Prej tyre 1 nga Gjykata e Apelit dhe 8 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave, përkatësisht divizioni i kundërvajtjeve.



Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive

Trajnim: Moduli bazik-aspekti civil material dhe procedural– E drejta e pronësore

Më 05-06 qershor 2023, në bashkëpunim me UNDP është vazhduar me trajnimet për grupin e II-të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave nga Moduli Bazik –aspekti civil me theks te “E drejta pronësore/ Pengim Posedimi”.

Qëllimi i këtij trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale e bashkëpunëtorëve profesional dhe e zyrtarëve ligjor në zbatimin e drejtë të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore për zgjidhjen e drejtë të kontesteve pronësore.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e nocioni të posedimit, natyrën, llojet e posedimit, fitimi dhe humbja e posedimi. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar mbrojtjes e posedimit duke theksuar që posedimi gëzon mbrojtje juridike, askush nuk mund të cenoj pushtetin faktik në mënyrë arbitrare, por vetëm me ndihmën e organeve kompetente. Poseduesi i sendit ka të drejtë në mbrojtje nga shqetësimet (pengimet) ose nga marrja e sendit nga posedimi, ku në këtë rast poseduesi zhvishet nga posedimi i sendit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë për Kompetencën, me ç ‘rast nga trajnuesit u njoftuan që në pikëpamje territoriale ekskluzivisht kompetente është gjykata ne territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm në të cilin ekziston posedimi. Gjithë ashtu u diskutua për llojet e padive, afatet për paraqitjen e padisë. Gjatë këtij trajnimi u elaborua servituti si një e drejtë sendore mbi sendin e huaj, ndarja e servituteve, mënyra e fitimeve të servituteve si dhe shuarja e servituteve.

Metodologjia e trajnimit ishte karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 28 bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor nga gjykatat. Prej tyre 1 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 5 nga Gjykata e Apelit dhe 21 të tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës si dhe 1 ndërmjetësues.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti civil material dhe procedural– E drejta e punës

Më 08 qershor 2023, në bashkëpunim me UNDP është vazhduar me trajnimet për grupin e II-të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave nga Moduli Bazik –aspekti civil me theks te “E drejta e punës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve profesionale e bashkëpunëtorëve profesional në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore të Ligjit të punës.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan afatet dhe procedurat për zgjidhjen e kontesteve të punës si dhe roli i gjykatës me rastin e ekzaminimit të padive në kontestet e punës, shkaqet për shkëputjen e marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës duke elaboruar nenin 67 të LP-së.

Në mënyrë të hollësishme u trajtuan:

Procedurat për mbrojtjen e të drejtave të punës, mbrojtjen e të drejtave të punësuarit brenda organeve të punëdhënësit si dhe mbrojtjen e të punësuarit në gjykatë. Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë për vendimet e gjykatës lidhur me kontestet e punës.

Metodologjia e trajnimit ishte karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 26 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat. Prej tyre 2 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 5 nga Gjykata e Apelit dhe 18 të tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës si dhe 1 ndërmjetësues.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti civil material dhe procedural– E drejta e detyrimeve

Më 12 qershor 2023, në bashkëpunim me UNDP është vazhduar me trajnimet për grupin e II-të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave nga Moduli Bazik –aspekti civil me theks te E drejta e detyrimeve”.

Qëllimi i këtij Trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale e bashkëpunëtorëve profesional dhe e zyrtarëve ligjor në zbatimin e drejtë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve për zgjidhjen e drejtë të kontesteve në gjykata.

Gjatë këtij trajnimi u theksua që Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve - (LMD), në mënyrë decisive nuk e ka përcaktuar nocionin e kontratës, por në dispozitën e nenit 15 përcakton së: “kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elemente thelbësore të kontratës”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite shihet qartë se në mënyrë parimore LMD nuk përcakton një moment formal si moment për tu konsideruar së është lidhë kontrata, por përcakton se kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës.

Në kuadër të këtij trajnimi u diskutua për kushtet të cilat duhet të plotësohen me rastin e lidhjes, efektet, interpretimi dhe konvalidimi i kontratave. Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë për kontratat nule, pasojat e nulitetit, mjetet e sigurimit të ekzekutimit t` kontratës, dëmin, bazat e përgjegjësisë dhe llojet e dëmit. Gjithashtu u diskutuan kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit, zvogëlimi i lartësisë së kompensimit për shkak të gjendjes materiale të dëmtuesit dhe të dëmtuarit për shkak të përgjegjësisë së ndarë si dhe lirimi nga përgjegjësia.

Metodologjia e trajnimit ishte karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 21 bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor nga gjykatat. Prej tyre 2 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 5 nga Gjykata e Apelit dhe 13 të tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regionet e Kosovës si dhe 1 ndërmjetësues.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal procedural-Grupi II

Më 14-16 qershor 2023, në bashkëpunim me SAEK, për Grupin e Iltë të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive që kanë përfunduar sesionet nga moduli bazik aspekti material penal është vazhduar me 3 sesionet e radhës për aspektin procedural penal me theks te Aktakuza - shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi, “Mjetet juridike dhe Procedurat e veçanta si dhe Fazat e procedurës penale”

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me aspektet procedurale që kanë të bëjnë me procedurën penale lidhur me çështjet ligjore të lartpërmendura.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese u diskutua për aktakuzën, shqyrtimin gjyqësor dhe arsyetimin, parimet, kompetencën dhe palët në procedurën penale, veprimet parapenale dhe fazat e procedurës penale, masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit në procedurën penale, si dhe fazat e procedurës penale.

Gjatë këtyre trajnimeve u trajtuan: Shqyrtimi gjyqësor dhe aktgjykimi, me tej u trajtuan Mjetet juridike, Administrimi i procedurës,

Procedura për dhënien e urdhërit ndëshkues si procedurë e veçantë si dhe Procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca. Gjatë këtyre trajnimeve u elaboruan Kallëzimi penal, Procedura paraprake, e ne veçanti Aktvendimi për hüdhe të kallëzimit penal, Aktvendimi për fillimin e hetimeve, Aktvendimi për zgjerimi të hetimeve si dhe Aktvendimi për pushim të hetimeve.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore, përmes punes ne grupe te hartojnë vendimet gjyqësore, të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

14 qershor 2023 përfitues në trajnim ishin 23 pjesëmarrës. Prej tyre 11 ishin bashkëpunëtorë profesional, 11 zyrtar ligjor dhe 1 refernet i lartë.

15 qershor 2023 përfitues në trajnim ishin 23 pjesëmarrës, prej tyre 10 bashkëpunëtorë profesional, 13 zyrtar ligjor.

16 qershor 2023 përfitues në trajnimin ishin 17 pjesëmarrës prej tyre 10 bashkëpunëtorë profesional, 17 zyrtar ligjor.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal procedural-Grupi III

Më 20 dhe 22 qershor 2023, në bashkëpunim me SAEK, është vazhduar me sesionet për Grupin e III-të nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor me temat “ Aktakuza - shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi, Mjetet juridike dhe procedurat e veçanta” .

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte përfshirja e gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive në këto trajnime dhe për më tepër avancimi i njohurive profesionale lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimin e drejtë në praktikën gjyqësore.

Për shkak të përmbajtjes së njejtë me sesionet

për grupin e dytë duke përfshirë edhe metodologjinë e trajnimit në vijim po pasqyrojmë vetëm përfituesit e këtyre sesioneve.

20 qershor 2023, Përfitues në trajnim ishin 28 pjesëmarrës, prej tyre 17 ishin bashkëpunëtorë profesional, 10 zyrtar ligjor dhe 1 referent i lartë.

22 qershor 2023, Përfitues në trajnim ishin 21 pjesëmarrës, prej tyre 12 bashkëpunëtorë profesional, 7 zyrtar ligjor, 1 sekretar juridik dhe 1 zyrtar për informim.



Aktivitetet trajnuese për gjyqtarë porot

Trajnimi për gjyqtarë porot fillestar

Nga data 22 qershor 2023 deri më 25 qershor 2023, Akademia e Drejtësisë, në koordinim edhe me Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka realizuar trajnimin fillestar për Gjyqtarët e sapo emëruar porotë në të gjitha regjionet e Republikës së Kosovës.

Sipas vendimit të KGJK të dt. 09 shkurt 2023, AD ka realizuar trajnimin teorik për gjyqtarët porotë të ndarë në 4 pjesë, duke u fokusuar tek Procedura Kontestimore, çështjet familjare, Etika dhe përgjegjësitë disiplinore si dhe testimi final.

Gjatë katër ditëve të trajnimit, 85 gjyqtarë porotë patën rastin të njihen më shumë me Parimet e procedurës kontestimore dhe

jokontestimore, kompetencat e gjykatës në kontestet martesore, padia për zgjidhjen e martesës, detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve porotë, procedura dhe masat disiplinore etj.

Në fund të trajnimit, gjyqtarët porotë i janë nënshtruar edhe testit me shkrim, të përgatitur nga AD në bashkëpunim me trajnuesit e angazhuar, me ç ‘rast bazuar në vendimin e KGJK, AD ka përfunduar obligimet e saj për trajnimin e gjyqtarëve porotë të sapoemëruar.

Pas trajnimit teorik, gjyqtarët porotë kanë ndjekur edhe nga 2 ditë trajnim praktik në gjykatat përkatëse ku ata janë emëruar.



Aktivitetet për trajnues

Trajnim për certifikimin e trajnuesve të AD-së

Më 13 qershor 2023, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Drejtësisë, zyra e OPDAT, kanë realizuar Trajnimin për certifikimin e Trajnuesve të AD-së.

Ky trajnim ka ardhur si vazhdimësi e certifikimit të trajnuesve që e bënë AD çdo vit, duke përbushur edhe kërkesën ligjore nga Ligji i AD-së për certifikimin e trajnuesve.

Synimi i këtij trajnimi ishte të përmirësoj trajnimin dhe trajnerët duke përdorur parimet e mësimin për të rritur dhe projektimin mësimor dhe multimedial.

Gjithashtu pjesëmarrësit patën rastin të mprehin aftësitë e tyre duke përfshirë ide të reja dhe informacione kthyes nga instruktorët dhe kolegët për të arritur sa vijon:

Të projektojnë objektivat, aktivitetet, përmbajtjen dhe strukturën për një prezantim të ardhshëm;

Të zhvillojnë materiale mbështetëse duke përdorur parimet e mësimin dhe projektimit për të rritur;





Të realizojnë një hapje efektive të prezantimit dhe të udhëhiqni një ushtrim angazhimi të audiencës.

Gjatë tre ditëve të trajnimit, pjesëmarrësit kanë punuar edhe në grupe punuese, të ndarë nga ekspertët amerikan znj. Stani Day, znj. Kimberly Klein dhe znj. Lynn Beard.

Në fund të trajnimit, të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata.




Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve

Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Instutucioneve - Qershor 2023




Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve


Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës-Qershor 2023






Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara-Qershor 2023



Pjesëmarrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike-Qershor 2023



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel: +383 38 200 18 660